



Ludwig Boltzmann Institut i të drejtave të njeriut me përkrahje financiare nga Bashkëpunimi austriak për zhvillim dhe Ministria për punë dhe politikë sociale me kënaqësi e shpall të ardhëshmen

Thirrje për aplikacione

për 8 (tetë) komuna bashkëpunëto

në kornizat e projektit

Përfshirja sociale dhe të drejtat e njeriut në Maqedoni

“QBDNj nga teoria në praktikë – Një dimension i ri i të drejtave të njeriut në përfshirjen sociale dhe uljen e varfërisë”

Projekti ka për qëllim që ta përkrahë përfshirjen e qasjes së bazuar mbi të drejtat e njeriut në proceset e planifikimit të autoriteteve kombëtare dhe lokale të cilat merren me çështjet e përfshirjes sociale, mbrojtjes sociale dhe uljes së varfërisë. Kjo përfshin identifikimin e grupeve të prekshme, konsolidimin e pjesëmarrjes së tyre në krijimin dhe zbatimin e politikave të posaçme të drejtuara kah përmirësimi i mirëqenies së tyre dhe përkrahjen e një sistemi efektiv të vëzhgimit të bartësve përkatës të detyrave.

Veçanërisht, projekti ka për qëllim që ti përforëtojë kapacitetet e zyrave të decentralizuara të MPPS (qendrat për punë sociale) dhe Agjencisë për punësim – si dhe autoritetet lokale për t’ju siguruar shërbime sociale të përshtatëshme shumicës së grupeve të prekshme duke i respektuar parimet e QBDNj. Duke e pasur parasysh procesin e decentralizimit, projekti do ta cekë detyrën e autoriteteve për të qenë më afër qytetarëve, posaçërisht më afër banorëve të prekshëm dhe të varfër. Projekti do ta përforëtojë koordinimin e shoqërisë civile në rolin e saj e të qenit një partner social dhe ti përmirësojë kapacitetet e saj në vëzhgimin e institucioneve për tu garantuar të drejtat të cilat burojnë nga instrumentet kombëtare dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut të cilat janë në fuqi në Maqedoni.

Përbrenda kornizave të projektit do të zbatohen aktivitetet e ardhëshme në komunat e përzgjedhura:

- Punë hulumtuese dhe trajnime për përfshirje sociale me adresim të posaçëm tek mbajtësit e detyrave në nivel lokal dhe kombëtar.
- Krijimi i Grupeve lokale bashkëpunëto (GLB) me secilën komunë të përzgjedhur me qëllim që të themelohet një platform për diskutim dhe zbatim të QBDNj në politikat e tyre për përfshirje sociale dhe mbrojtje sociale.

- Aktivitete për përforsim të kapaciteteve për secilin grup të komunave të përzgjedhura për përfshirje sociale, QBDNj dhe të drejtat e njeriut
- Përgatitja e dokumenteve strategjike.
- Zbatimi i mikro-projekteve nga OJQët lokale si përkrahje për dokumentet strategjike me një shumë prej 9.000 euro (është i domosdoshëm kofinancim me shumë prej 2000 euro nga secila komunë).
- Përforsimi i kapaciteteve të OJQëve në aspekt të vëzhgimit dhe pjesëmarrjes publike.

Përparësi do të kenë komunat ku personeli i tyre do të dëshmojë një përkushtimi të vendosur.

Aplikacioni mund të gjendet në ueb faqen e ardhëshme: <http://bim.lbg.ac.at/makedonija>

dhe duhet të dorëzohet tek

Ludwig Boltzmann Institute of Human Rights (BIM-Skopje)
Veljko Vlahovic 1a/1-4, 1000 Skopje

jo më vonë se 31.03.2010

Për informata plotësuese lirisht mund të na kontaktoni përmes telefonave të cekura më poshtë ose përmes postës elektronike

Tel.: +389 2 3216 956
Fax.: +389 2 3216 982
e-mail: Jagoda.iljov@univie.ac.at

**Me qëllim që të përforsohet bashkëpunimi ndërkomunal, aplikacioni i grupeve të komunave fqinje do të ketë përparësi përpara aplikantëve të vetëm.*